

	<b>POLITIKA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË</b>	<b>PO-SSHM-004</b>
	ver. 2.0	faqe 1 nga 1
<small>OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d</small>	<small>KOSTT sh.a Report</small> Dokumenti: <i>Burimet Njerëzore</i>	Sektori: <i>Siguria, Shëndeti dhe Mjedis</i>

Nr. 881 Dt. 06.05.2021  
PRISHTINË - A

**POLITIKA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË**

KOSTT sh.a, është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. KOSTT është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në vend.

KOSTT sh.a. ofron mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm për të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe vizitorët të cilët përdorin hapësirat dhe pajisjet e KOSTT me qëllim të parandalimit të lëndimeve dhe ruajtjes së shëndetit. Menaxhmenti është i përkushtuar që këtë ta arrijë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore në fuqi dhe duke zbatuar po ashtu kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë sipas ISO 45001:2018.

Menaxhmenti i KOSTT është i përkushtuar që në vazhdimësi të zbatojë, mirëmbajë dhe përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e punonjësve nëpërmjet:

- definimit dhe zbatimit të rregullave në fushën e sigurisë në punë të krijuara në përputhje me kërkesat ligjore, aktet rregullatore duke konsideruar natyrën e veprimtarisë të KOSTT
- gatishmërisë për sigurimin e kushteve dhe mjedisit për parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera në lidhje me punën
- identifikimit dhe evitimit të rreziqeve të cilat në kushte të caktuara mund të shkaktojnë lëndime apo dëmtim të shëndetit
- nxitjes së zbatimit të rregullave dhe masave praktike nga ana e punonjësve,
- aftësimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve duke përfshirë edhe aftësimin e nevojshëm profesional, si dhe
- motivimit të personelit të cilët në çfarëdo mënyre janë të kyçur apo përgjegjës në arritjen e objektivave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Politika e Sigurisë dhe Shëndetit në punë do të jetë orientim bazë e KOSTT-it për vendosjen dhe arritjen e objektivave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kjo politikë do t'i komunikohet të gjithë punonjësve dhe palëve tjera të interesit të KOSTT dhe do të rishikohet vazhdimisht me qëllim të zbatimit të përshatshëm dhe konform zhvillimeve aktuale.

Data: 06.05.2021

Kryeshafi Ekzekutiv  
Mustafë Hasani, PhD


